

- **Procedura per marrjen e vendimeve per vendimet e favorshme**

1. Kur një person aplikon për marrjen e një vendimi në favor të tij, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, ky person duhet të vërë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar nga autoritetet doganore kompetente, në mënyrë që ato të jenë në gjendje për të marrë këtë vendim. Në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin doganor, një vendim i tillë gjithashtu mund të kërkohej nga/dhe të merret në lidhje me disa persona. Përveçse kur parashikohet ndryshe, autoritet doganor kompetent është ai i vendit ku aplikuesi mban kontabilitetin kryesor për qëllime doganore dhe ku ai kryen të paktën një pjesë të aktivitetit që përfshihet në vendim.

2. Autoritetet doganore, maksimumi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit për një vendim të favorshëm, verifikojnë nëse janë përmbushur kushtet për pranimin e këtij aplikimi. Kur autoritetet doganore arrijnë në përfundimin se aplikimi përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që mundëson marrjen e një vendimi prej tyre, ato ia komunikojnë aplikuesit pranimin e aplikimit brenda afatit të sipërpërmendur.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, një vendim, siç përmendet në pikën 1, merret dhe i njoftohet pa vonesë aplikuesit, maksimumi brenda 120 ditëve nga data e pranimit të aplikimit. Kur autoritetet doganore nuk janë në gjendje të përmbushin afatin kohor për marrjen e vendimit, ato duhet ta informojnë aplikuesin për këtë fakt para mbarimit të këtij afati, duke deklaruar arsyet dhe duke përcaktuar afatin tjetër kohor, të cilin ato e konsiderojnë të nevojshëm për të marrë një vendim. Përveçse kur është përcaktuar ndryshe, afati shtesë i përcaktuar nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë. Pa rënë ndesh me paragrafin e dytë të kësaj pike, autoritetet doganore mund ta zgjatin afatin kohor për marrjen e një vendimi, siç përcaktohet në legjislacionin doganor, kur aplikuesi kërkon një zgjatje të afatit, me qëllim që të kryejë rregullimet e duhura për të siguruar plotësimin e kushteve e të kritereve. Këto përmirësime dhe afati i mëtejshëm, i nevojshëm për plotësimin e kushteve dhe kritereve, u komunikohet autoriteteve doganore, të cilat do të marrin vendim për zgjatjen e afatit.

4. Përveçse kur përcaktohet ndryshe në vendim ose në legjislacionin doganor, vendimi i favorshëm hyn në fuqi në datën, në të cilën aplikuesi e merr vendimin ose konsiderohet sikur ta ketë marrë atë. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, të nenit 46, vendimet e miratuara zbatohen nga autoritetet doganore që nga kjo datë.

5. Përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin doganor, vendimi është i vlefshëm pa afat kohor. 6. Para se të refuzojnë marrjen e një vendimi të favorshëm për aplikuesin, autoritetet doganore i komunikojnë atij arsyet, mbi të cilat ato do të mbështetin vendimin e tyre, duke i dhënë edhe mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tij brenda një afati të caktuar, që nga data kur është bërë komunikimi ose që konsiderohet si i bërë. Pas mbarimit të këtij afati kohor, aplikuesi njoftohet për vendimin.

- **Procedura per marrjen e vendimeve per kundravajtjet administrative**

Autoritetet doganore kompetente, për shkeljen e konstatuar, përgatitin dosjen e plotë, në lidhje me shkeljen, dhe marrin vendimin përkatës.

2. Vendimi i autoriteteve doganore kompetente për pagimin e detyrimeve të importit ose eksportit dhe/ose të sanksioneve përkatëse, të përcaktuara në këtë Kod, merret në rastet e flagrancës/urgjencës, brenda 24 orëve nga momenti i mbajtjes të procesverbalit të verifikimit të shkeljes dhe i njoftohet shkelësit brenda 24 orëve nga marrja e vendimit.

3. Në raste të tjera, vendimi i autoriteteve doganore kompetente merret:

a) kur procesverbali për verifikimin e shkeljes është mbajtur nga vetë autoriteti doganor kompetent, maksimumi brenda 60 ditëve kalendarike nga data kur shkelësit i përfundon afati për paraqitjen e pretendimeve për procesverbalin, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 273, dhe i njoftohet me shkrim shkelësit, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit,

b) kur procesverbali për verifikimin e shkeljes është mbajtur nga strukturat e tjera kontrolluese, maksimumi brenda 60 ditëve kalendarike nga data kur autoriteti doganor kompetent ka marrë dijeni për procesverbalin, sipas përcaktimeve të pikës 5, të nenit 273, dhe i njoftohet me shkrim shkelësit brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit.

4. Kur autoriteti doganor kompetent vlerëson se nuk duhet marrë vendim për një procesverbal, u komunikon strukturave doganore, që kanë hartuar procesverbalin e verifikimit të shkeljes, arsyet e mosmarrjes së vendimit.